



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:051596  
Datë: 21.06.2024  
Numri i dokumentit: 05847801

KPPP.nr.812/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Kimi” SH.P.K., me NUI:810727638, me seli në Obiliq C. Vodica, kundër debitorit “DP & PARTNERS” Sh.P.K., me NUI:811302471, me pronar D.P., me seli në Prishtinë Rr.”Enver Maloku”, Kompleksi Tregtia pn., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.290/21 të datës 26.02.2021 të Përmbartuesit Privat Valdrin Beka me seli në Magjistralen Prishtinë- Shkup, jashtë seancës me datën 21.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “DP & PARTNERS” Sh.P.K., me NUI:811302471, me seli në Prishtinë, ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.291/21 të datës 26.02.2021, i Përmbartuesit Privat Isa Gacaferi, PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrit Përmbartimor P.nr.290/21 të datës 26.02.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumenteve të besueshme – fatura me numër 2111-1 e datës 21.10.2019, fatura me numër 1911-1 e datës 19.11.2019, fatura me numër 1911-2 e datës 19.11.2019, fatura me numër 69/19 e datës 30.11.2019, fatura me numër 70-19 e datës 18.12.2019, fatura me numër 6-20 e datës 01.02.2020, fatura me numër 7/20 e datës 03.02.2020, fatura me numër 9/20 e datës 04.02.2020, fatura me numër 10/20 e datës 15.02.2020, fatura me numër 17-20 e datës 12.03.2020, fatura me numër 15/20 e datës 08.05.2020, fatura me numër 16/20 e datës 11.05.2020, fatura me numër 18/20 e datës 12.05.2020, fatura me numër 19/20 e datës 13.05.2020, fatura me numër 28/20 e datës

09.06.2020, fatura me numër 29/20 e datës 09.06.2020, fatura me numër 31/20 e datës 11.06.2020, fatura me numër 33/20 e datës 15.06.2020, fatura me numër 37/20 e datës 20.06.2020, fatura me numër 39/20 e datës 30.06.2020, fatura me numër 52/20 e datës 29.07.2020, fatura me numër 55/20 e datës 11.08.2020, fatura me numër 61/20 e datës 25.08.2020, fatura me numër 62/20 e datës 28.08.2020 dhe fatura me numër 5/20 e datës 22.01.2020 , në bazë të këtyre faturave debitori është i obliguar ti paguaj kreditorit shumën prej 409.443,10 euro, meqenëse debitori nuk e ka përmbushur në tërësi obligimin, e ka urdhëruar debitorin në emër të borxhit të mbetur t'ia paguaj kreditorit shumën totale në vlerë prej 120,050.85 €, me kamatë ligjore prej 8 %, shpenzimet e procedurës përmbartimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë. Ndërsa nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare, përmbartuesi privat të zbatoj përmbartimin përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Debitori ka parashtruar prapësimin përmes të cilit e kundërshton urdhrin përmbartimor, ndër të tjerash ka theksuar se urdhri për përmbartim është lëshuar në bazë të faturave fiktive të kreditorit, sepse debitori i ka përmbushur detyrimet e tij ndaj kreditorit dhe se faturat në bazë të cilave është caktuar përmbartimi nuk paraqesin dokument të besueshëm. Ka theksuar se nuk është gjendja faktike ajo që e ka paraqitur kreditori por është një gjendje tjetër sepse është kreditori ai që i ka borxh debitorit dhe jo debitori kreditorit. Ka shtuar se urdhrin përmbartimor e kundërshton duke u bazuar në nenin 71 par.1 nënpar.1 dhe 1.6 të LPP-së, si dhe faturat në bazë të cilave është caktuar përmbartimi nuk paraqesin dokument të besueshëm. Andaj i ka propozuar gjykatës ta aprovoj prapësimin si të bazuar, të anulohet urdhri përmbartimor si dhe të obligohet kreditori që t'i mbuloj të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kreditori brenda afatit ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim, ka deklaruar se pretendimet e debitorit nuk qëndrojnë dhe si të tilla janë të pa bazuara. Ndër të tjerash ka theksuar këtu nuk kemi të bëjmë me asnjë faturë fiktive por kemi të bëjmë me fatura reale dhe të pranuar nga debitori që në të njëjtën kohë janë të deklaruara në ATK. Ka shtuar se nuk qëndron pretendimi se i ka përmbushur obligimet ndaj kreditorit për shkak se përmes llogarisë bankare dëshmohet qartë se debitori nuk e ka përmbushur në tërësi obligimin ndaj kreditorit. Po ashtu e ka kundërshtuar pretendimin se debitori me kreditorin janë kompensuar përmes kontratave duke theksuar se debitori nuk i është përmbartur kontratës së banesave dhe i njëjti nuk ka transferuar

pagesën. I ka propozuar gjykatës që prapësimi të refuzohet në tërësi si i pa bazuar dhe urdhri për përmbaerim të vërtetohet.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbaerimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbaerimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbaerimor duhet të anulohet dhe procedura përmbaerimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura me numër 2111-1 e datës 21.10.2019, fatura me numër 1911-1 e datës 19.11.2019, fatura me numër 1911-2 e datës 19.11.2019, fatura me numër 37/20 e datës 20.06.2020, fatura me numër 39/20 e datës 30.06.2020, fatura me numër 52/20 e datës 29.07.2020, fatura me numër 55/20 e datës 11.08.2020, fatura me numër 61/20 e datës 25.08.2020, fatura me numër 62/20 e datës 28.08.2020, në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbaerim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbaerimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbaerim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbaerim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbaerimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Sipas nenit 38 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Propozimi për përmbaerim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbaerim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbaerimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbaerimi, kërkuesi i përmbaerimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbaerimi, objekti i përmbaerimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të*

*nevojshme për zbatimin e përmbartimit”, ndërsa sipas nenit 40 parag. 1 nën parag. 1 të LPP-së përcaktohet 1. Propozimi për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm duhet të përmbajë:  
1.1. kërkesën përmbartimore nga paragrafi 1. i nenit 38 të këtij ligji;*

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se nëntë nga faturat në bazë të cilave është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme, për faktin se këto fatura në rastin konkret janë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk janë pranuar nga debitori, përkatësisht të njëjtat nuk përmbajnë vulën e as nënshkrimin e pranuesit - debitorit dhe nuk ka dëshmi se të njëjtat janë pranuar nga debitori. Andaj, duke qenë se debitori nuk i ka pranuar në mënyrë të rregullt, si të tilla të njëjtat nuk mund të shërbejnë si dokumente të besueshme dhe nuk kanë tipare të përmbartueshmërisë.

Gjykata vlerësoj pretendimet e kreditorit lidhur me pranimin e faturave të lartcekura dhe disa pagesave të realizuara nga debitori mirëpo gjeti se fatura me numër 2111-1 e datës 21.10.2019, fatura me numër 1911-1 e datës 19.11.2019, fatura me numër 1911-2 e datës 19.11.2019, fatura me numër 37/20 e datës 20.06.2020, fatura me numër 39/20 e datës 30.06.2020, fatura me numër 52/20 e datës 29.07.2020, fatura me numër 55/20 e datës 11.08.2020, fatura me numër 61/20 e datës 25.08.2020, fatura me numër 62/20 e datës 28.08.2020, nuk përmbajnë as nënshkrimin e pranuesit - debitorit dhe nuk ka dëshmi se të njëjtat janë pranuar nga debitori, ndërsa fatura me numër 69/19 e datës 30.11.2019, fatura me numër 70-19 e datës 18.12.2019, fatura me numër 6-20 e datës 01.02.2020, fatura me numër 7/20 e datës 03.02.2020, fatura me numër 9/20 e datës 04.02.2020, fatura me numër 10/20 e datës 15.02.2020, fatura me numër 17-20 e datës 12.03.2020, fatura me numër 15/20 e datës 08.05.2020, fatura me numër 16/20 e datës 11.05.2020, fatura me numër 18/20 e datës 12.05.2020, fatura me numër 19/20 e datës 13.05.2020, fatura me numër 28/20 e datës 09.06.2020, fatura me numër 29/20 e datës 09.06.2020, fatura me numër 31/20 e datës 11.06.2020, fatura me numër 33/20 e datës 15.06.2020, dhe fatura me numër 5/20 e datës 22.01.2020, përmbajnë nënshkrimin dhe vulën në faturë, por që vlera e përgjithshme e këtyre faturave të nënshkruara arrijnë shumën prej 264,842.05 €, ndërsa shuma e kërkuar sipas këtij urdhri është në shumën prej 120,050.85 €, ashtu që urdhri përmbartimor është i paqartë dhe nuk precizohet pjesa e borxhit e cila është paguar dhe e cila kërkohet. Andaj kreditori nuk ka vepruar konform nenit 38 par.1 të LPP-së, për faktin se nuk dihet saktë kërkesa e kreditorit se për cilat

fatura është precizuar borxhi si në propozim, ashtu që në këtë fazë të procedurës për gjykatën është e paqartë kërkesa e kreditorit dhe si e tillë përmban të meta sipas kësaj dispozite.

Gjykata po ashtu vlerësoj edhe pretendimet tjera të paraqitura nga kreditori dhe debitori dhe erdhi në përfundim se pretendimet e tilla janë pa mbështetje ligjore në këtë procedurë, ngase në këtë procedurë, kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësimet tjera të paraqitura nga debitori dhe kreditori, sepse të njëjtat pretendime mund të realizohen në ndonjë procedurë tjetër eventuale, e assesi në këtë procedurë, sepse kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit ndalohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, dhe 27 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.812/22, datë 21.06.2024

Gjyqtari

Gent Bekeri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.